



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:087893

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06099968

KF.nr.528/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me zyrtaren ligjore Vesa Statovci, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Europancolor” Sh.P.K., me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlerë kontesti 1,351.54 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, avokat Kushtrim Bytyqi dhe të përfaqësueses të autorizuar të palës së paditur, K.Sh., me datë 01.08.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Europancolor” Sh.P.K., me seli në Prizren.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.01.3.2.2/4205/2019 i datës 03.12.2020 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit “Europancolor” Sh.P.K., me seli në Prizren, t’ia kthej shumën prej 1,351.54 €, (një/mijë/e/treqind/e/pesëdhjetë/e/një/euro/e/pesëdhjetë/e/katër/cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-4719/04.03.2019, të proceduar në ZD Hani i Elezit, me kamatë ligjore prej 8% nga data 05.03.2019, e deri në pagesën e plotë të kësaj shume.
- IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësi “Europancolor” Sh.P.K., me seli në Prizren, përmes përfaqësuesit të autorizuar me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 07.05.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë për anulimin e vendimit nr.01.3.2.2/4205/2019 i datës 31.03.2021, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet si bazuar kërkesëpadia e paditësit, të anulohet aktvendimi i Sektorit të Rishqyrtimeve i Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/4205/2019 i datës 31.03.2021 dhe të detyrohet e paditura që ti kthejë paditësit mjetet e paguara në emër të detyrimeve të importit të paguar mbi vlerën e transaksionit sipas DUD-it, R-4719/04.03.2019, për shkak të rivlerësimit, në shumë prej 1,351.54 Euro, me kamatë në shkallë prej 8%, deri në kthimin e plotë. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se: Mbetemi në tërësi pranë kërkesëpadiës dhe të gjitha deklaratimeve në padi, duke konsideruar se e paditura ka bërë shkelje ligjore të referuara në padi, përkatësisht nenin 33 të KDA-së, lidhur me nenin 123 të UA11/2009, pasi paditësi DUD-it kontestues i ka bashkëngjitur dokumentet relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit, përfshirë këtu edhe urdhër pagesën bankare në emër të faturës së mallit, e me të cilën vërtetohet çmimi i paguar nga paditësi për mallin e importuar. E paditura, ka refuzuar kërkesën e paditësit me arsyetim të mungesës së dokumenteve të cilat nuk janë përcaktuar si obligative në dispozitat ligjore të theksuara si më sipër, dhe konsiderojmë se ka vërtetuar në mënyrë të paguar gjendjen faktike me rastin e krahasimit të çmimit të mallit, për shkak se ka marrë për bazë oferta nga interneti e jo çmime reale ose finale të paguara nga ndonjë blerës tjetër. E paditura, as në procedurën e rishqyrtimit sipas Aktgjykimit A.nr.1386/19 i datës 18.02.2021, nuk ka marrë për bazë vërejtjet dhe rekomandimet e gjykatës, për rishqyrtimin e kërkesës së paditësit në bazë të dokumenteve të transaksionit. Prandaj, i propozoj gjykatës të administrojë provat e bashkëngjitura dhe të veprojë sipas kërkesëpadiës me të cilën bëhet vetëm ndryshimi i datës për rrjedhjen e kamatës e cila duhet të jetë nga data 05.03.2019, sipas dëshmisë bankare për pagesën e taksave doganore shtesë, dëshmi të cilën e dorëzoj në këtë seancë, e jo nga data 04.03.2019, siç është theksuar në padi. Dokumenti i titulluar *Commercial Agreement* në shkresat e lëndës, nuk paraqet kontratë për shit blerje të mallit, por është listë tabelare për konfirmim të çmimeve, e cila përputhet sikurse me të dhënat në faturë. Sa i përket transferit bankar, i njëjti është realizuar përmes bankës sipas detajeve bankare të evidentuara në faturë në të cilën eksportuesi i ka evidentuar mënyra të ndryshme të pagesës, ndërsa paditësi e ka realizuar atë përmes bankës në llogarinë përfituese të eksportuesit që është evidentuar në faturë. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar, ashtu që ta anulojë

aktvendimin e atakuar dhe ta detyrojë të paditurën që t'i kthejë paditësit mjetet e paguara më tepër për shkak të rivlerësimit të mallit, sipas DUD-it kontestues në shumën prej 1,351.54 Euro, me kamatë prej 8% nga data 05.03.2019 e deri në kthimin e plotë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 26.10.2021, e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marr konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marr me shkelje ligjore nuk qëndron fare me arsyetimin se vendimi i atakuar është marr konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka arsyetuar as edhe me një provë të vetme. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor e autorizuari e palës së paditur deklaroi se: E paditura e konteston në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave ligjore në fuqi, dhe ajo për të cilën pretendon pala paditëse, se ky vendim është marrë me shkelje ligjore, nuk qëndron fare me arsyetimin se dogana gjatë shqyrtimit të provave të administruara, ka vërejtur se kontrata e bashkëngjitur, përpos që nuk përmban elementet esenciale të një kontrate, e njëjta është nënshkruar vetëm nga shitësi. Tutje, lidhur me faturën e bashkëngjitur me numër GRG2019000000081, e datës 28.02.2019, për mallin kontestues, dogana ka vërejtur se në detajet e kësaj fature, mënyra e pagesës është e evidentuar me para të gatshme, gjë që referuar transaksionit bankar të datës 27.05.2019, të realizuar për të njëjtën faturë, nuk paraqet prove bindëse se çmimi i paguar për çmim përfundimtar i paguar për mallin kontestues. Andaj mbi këtë bazë dhe marrë parasysh se për mallrat e ngjashme dogana disponon me të dhënat me çmime dukshëm më të larta se sa çmimet sikurse në rastin konkret. Vlera e kontestit në shumë prej 1,351.54 Euro, siç është theksuar në padi, e njëjta përputhet me të dhënat e doganës. Gjykatës i ka propozuar që të marrë Aktgjykim, me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, duke e lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik të datës 01.08.2024, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 4205/2019 i datës 31.03.2021, DUD-i 4719/04.03.2019, në versionin me MV1 dhe MV6, Fatura GRG 2019000000081, Konfirmimi bankar SWIFT MT 103 i datës 27.05.2019, Fatura-marrëveshje pa numër dhe datë, Deklarata EX1, Përgjigja në padi, DUD-at 9883, 11298, 6668, 8550, 4719, 18885, 1502, Aktvendimi 4205/07.05.2019, Ankesa e ushtruar në doganë e datës

03.04.2019, Kuponi fiskal i datës 05.03.2019, Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Faturat shitëse dhe Pagesa bankare e detyrimeve doganore e datës 05.03.2019.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Në këtë procedurë gjyqësore të kontestit tregtar administrativ në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se Sektori i Pranimit Qendror subjektit në procedurë, i ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sipas Deklaratës Unike Doganore R-4719/04.03.2019, ndërsa në proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave kanë cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së gjashtë (6) të vlerësimit. Nuk është kontestues as fakti se subjekti ankimor këtu paditësi ka ushtuar kërkesë për rishqyrtimin e vendimit tek Sektori i Rishqyrtimeve të vendimeve, i cili ka refuzuar kërkesën si të pabazuar. Po ashtu nuk është kontestues edhe fakti se paditësi ka parashtruar padi pran Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila me aktgjykim A.nr.1386/19 i datës 18.02.2021, e ka aprovuar kërkesëpadinë si të bazuar, e ka anuluar vendimin e atakuar dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim. Jo kontestues mbetet edhe fakti se Dogana e Kosovës sipas Aktgjykimit A.nr.1386/19 i datës 18.02.2021, ka sjell aktvendimin 01.3.2.2/4205/2019 i datës 31.03.2021, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektit këtu paditësit, e ndaj të cilit aktvendim paditësi me padinë e datës 07.05.2021 ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Gjykata konstaton se e paditura vendimin kontestues ndonëse e ka nxjerr në ri procedurë duke vepruar në zbatim të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1386/19 datë 18.02.2021, ajo nuk i ka respektuar pikëpamjet juridike të Gjykatës, pra ka nxjerr vendim në kundërshtim me udhëzimet dhe vërejtjet e Gjykatës, duke anashkaluar kështu detyrimet ligjore nga neni 65 i LKA-së.

Gjykata vlerëson se e paditura sikurse në aktvendimin e parë refuzues me nr.01.3.2.2/4205 të datës 07.05.2019 ka dhënë arsyetim të njëjtë sa i përket bazës ligjore ku e paditura e ka mbështetur vendimin e kontestuar edhe në aktvendimin tani kontestues nr.01.3.2.2/4205/2019 të datës 31.03.2021.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve-Dogana e Kosovës ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e R-4719/04.03.2019 të ZD Hani i Elezit si e pa bazuar. Tutje e paditura në vendimin kontestues ka konstatuar se Sektori i Pranimet Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor si në Deklaratën Unike Doganore kontestuese, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendim tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Po ashtu, e paditura në vendimin kontestues ke theksuar se bazuar në përshkrimin e evidentuar sipas rubrikës 31 të DUD-it kontestues, referuar të dhënave në sistemin ASYCUDA dhe COGNOS ka gjetur se në periudhë të njëjtë kohore, për mallin e ngjashëm, me kod të njëjtë tarifor, origjinë dhe shtet eksportues të njëjtë, janë zhdoganuar mallra me çmim më të lartë se sa vlera e deklaruar e mallit lëndor kontestues. Tutja ka cekur se fatura e bashkangjitur GRG 2019000000081 e datës 28.02.2019 për mallin lëndor kontestues, Dogana e Kosovës ka vërejtur se në detajet e kësaj fature mënyra e pagesës është evidentuar me para të gatshme gjë që është referuar transaksionit bankar i realizuar në emër të së njëjtë faturë nuk paraqet prova bindëse se çmimi i paguar është çmimi përfundimtar i paguar për mallin lëndor. Po ashtu, e paditura në vendimin kontestues ka konstatuar se Sektori i Pranimet Qendror ka vepruar drejtë kur ka vlerësuar mallin bazuar në nenin 35 të KDA-së, respektivisht sipas të dhënave të disponueshme.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore dhe prova materiale të besueshme e ka rivlerësuar mallin lëndor të deklaruar për zhdoganim nga paditësi, përmes DUD-it nr. R-4719/04.03.2019, të ZD Hani i Elezit dhe në këtë mënyrë të njëjtin e ka obliguar pa të drejtë me pagesën e detyrimeve shtesë importuese doganore në shumë prej 1,35.54 € mbi vlerën e deklaruar të mallit të importuar.

Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se me asnjë provë nuk është provuar konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar, sipas të cilit vlera e deklaruar e mallit lëndor nga paditësi, nuk është vlera reale e paguar e mallit me qëllim importi në vendin tonë në vështrim të nenit 33 të KDAK-së. Gjykata konsideron se e paditura do të mund ta mbështeste një konstatim të këtillë vetëm atëherë kur do të mund të siguronte dëshmi konkrete se paditësi për mallin lëndor kontestues, i ka paguar eksportuesit mbi çmimin neto të faturës të mallit, ku vlera e mallit të

faturuar me faturën GRG 2019000000081 të datës 28.02.2019 është paguar nga paditësi e cila vërtetohet me konfirmim bankar SWIFT MT 103 i datës 27.05.2019, në emër të faturës dhe e cila është në harmoni të plotë në kuptim të shumës, dhe përfituesit si në fatura.

Gjykata vlerëson se nuk përbën shkak ligjor për rivlerësim të mallit dhe caktim të bazës së re doganore për paditësin, fakti që e paditura disponon me të dhëna nga Dosja e vlerës-zhdoganimet e mëhershme, në bazë të së cilës vlera e mallit është dukshëm më e lartë se vlera e deklaruar nga subjekti, sepse me dispozitën ligjore të nenit 31 par.1 të KDAK-së nuk thuhet që vlera doganore e mallrave të importuar duhet të jetë e njëjtë me vlerën e mallrave të marra nga Dosja e Vlerës, por aty përkundrazi shprehimisht përcaktohet se *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 33 të KDAK-së është parashikuar që *“Çmimi vërtetë i paguar apo i pagueshëm është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin ose në dobi të këtij të fundit për mallin e importuar dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara nga blerësi për shitësit, ose nga blerësi për një palë të tretë për ta përmbushë obligimin ndaj shitësit. Pagesa mund të mos bëhet patjetër në formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose ndonjë mjeti tjetër të dakorduar të pagesës dhe mund të bëhet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë”*.

Sipas nenit 123 par. 1 pika (a) të UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109, është parashikuar që dokumenti që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*.

Në interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të cituara, Gjykata konstaton se në rastin konkret paditësi ka paraqitur faturën e mallit lëndor GRG 2019000000081 të datës 28.02.2019 nga eksportuesi dhe e njëjtat është paguar nga paditësi e cila vërtetohet përmes konfirmim bankar SWIFT MT 103 i datës 27.05.2019, në emër të faturës dhe e cila është në harmoni të plotë në kuptim të shumës si në faturë. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar nga paditësi në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Prandaj, nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për zhdoganimin e mallit lëndor, komfor nenit 33 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Nisur nga kjo, gjykata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 292 pika b, të KDAK-së nr.03/L-109, nenit 46 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, miratoj kërkesëpadinë e paditësit, e anuloi vendimin e kontestuar të paditurës dhe e detyroj të paditurën që paditësit t'ia kthej shumën prej 1,351.54 €, (një mijë e treqindën e pesëdhjetë e një euro e pesëdhjetë e katër cent), të paguar më tepër në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr. R-4719/04.03.2019, të proceduar në ZD Hani i Elezit, me kamatë ligjore prej 8% nga data e pagesës së detyrimeve doganore 05.03.2019 e deri në pagesën e plotë të kësaj shume.

Gjykata konstaton se shuma e paguar më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore, si pasojë e rivlerësimit të mallit nga e paditura nuk u kontestua as nga përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor i cili theksoi se: *“Vlera e kontestit në shumë 1,351.54 eEuro, siç është theksuar në padi, e njëjta përputhet me të dhënat e doganës”*, andaj edhe kjo shumë për Gjykatën paraqet shumën jo kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse të detyrimeve doganore të paguar më tepër nga paditësi si rezultat i ri-vlerësimit të mallit nga e paditura.

Sa i përket kamatës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, duke pasur parasysh dispozitën e nenit 292 pika b) (i), të KDAK-së nr.03/L-109, ku parashihet *Në rast se çështja zgjidhet përfundimisht në instance të fundit sipas mjetit të ushtruar në favor: Të Apeluesit, Dogana duhet që: (i) të rikthejë çdo detyrim të importit apo eksportit të paguar më tepër bashkë me kamatën e grumbulluar deri në momentin e zgjidhjes së kontestit nëse është e aplikueshme dhe dispozitat ligjore të nenit 170 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku thuhet se Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit dhe nenit 382 paragrafi 2 të këtij ligji ku thuhet se *Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*, ndërsa lidhur me datën e rrjedhës së kamatës është marrë data 05.03.2019, si datë e pagesës së taksës doganore shtesë të realizuar në bankë.*

Gjykata i ka vlerësuar deklarinmet dhe provat tjera materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par. 2, 4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e shkallës së parë / Departamenti Fiskal  
KF.nr.528/22, datë 01.08.2024

Zyrtare Ligjore  
Vesa STATOVCI

Gj y q t a r i,  
Fisnik NULI

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.